



Në bazë të Marrëveshjes për bashkëpunim në mes Agjencisë për punësime të RMV-së (APRMV), Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Qytetit të Shkupit, Planit operativ për programet dhe masat aktive për punësime dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2019, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programit për angazhime në punët e dobishme – komunale, të financuar nga Buxheti i Agjencisë për punësime të RMV-së, më datën 05.08.2019 shpallet:

KONKURS PUBLIK
për personat e evidentuar si të papunësuar për kyçe në
Programin për angazhime në punët e dobishme komunale

Ftohen të gjithë personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët shprehin interesim që të kyçen në Programin për angazhime në punët e dobishme komunale, projekti “Përkrahja e inkluzionit në procesin arsimorë - avancimi i të drejtave dhe mundësive të kategorive të cenuara të qytetarëve në Qytetin e Shkupit”, për angazhim pune për 20 (njëzet) orë gjatë javës për periudhën prej 9 (nëntë) muaj me qëllim të përfitimit të aftësive dhe kyçjes së tyre graduale në tregun e punës, të paraqiten në Agjencinë për punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të kyçen në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, do të angazhohen me punë me orar pune për 20 (njëzet) orë pune në javë.

Gjatë periudhës së angazhimit punues përmes programit “Angazhime në punët e dobishme komunale”, statusi i personit të papunësuar u mbetet i pandryshuar dhe të njëjtit janë të detyruar që me rregull të paraqiten në Agjencinë për punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Qendra për punësime e qytetit të Shkupit me qëllim të respektimit të obligimeve që pasojnë në pajtim me Ligjin. Personave të papunësuar – shfrytëzues të ndihmës sociale gjatë kohëzgjatjes së angazhimit punues do tu mbetet aktive e drejta e shfrytëzimit të ndihmës sociale.

Të drejtën për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, e gëzojnë të gjithë personat e papunësuar, gjatë kësaj përparësi do të kenë personat të cilët për herë të parë paraqiten për pjesëmarrje në këtë Program.

Për kandidatët të cilët do të zgjidhen dhe kyçen në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, parashikohet kompensimi monetarë në lartësi prej 9.000 denarë në muaj, duke llogaritur tatimin personal të të ardhurave dhe sigurimin për invaliditet dhe lëndime trupore në raste të fatkeqësisë gjatë angazhimit punues dhe shfaqjes së sëmundjeve profesionale.

Personat e evidentuar si të papunësuar, të cilët do të paraqiten për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, duhet ti përkasin njërit prej grupeve vijuese të synuara të personave të papunësuar:

- Persona të papunësuar një periudhë më të gjatë kohore (mbi 12 muaj në evidencën, me përparësi për personat që janë të papunësuar mbi 5 vite)
- Persona të rinj të moshës deri më 29 vjeçare
- Persona më të moshuar se 50 vite
- Persona shfrytëzues të ndihmës sociale ose të kompensimit monetarë në bazë të papunësisë
- Persona që kanë qenë shfrytëzues të Programit për kompensime të kushtëzuara monetare për arsimin e mesëm
- Persona të cilët kanë pasur statutin e fëmijëve pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore
- Viktima të dhunës familjare
- Persona të gjinisë femërore, përkatës të bashkësisë etnike rome
- Prindër të vetëm
- Prindër të fëmijëve të cilët ballafaqohen me pengesa gjatë zhvillimit
- Prindër të 3 dhe më shumë fëmijëve

Pozitat punuese të përfshira me këtë konkurs, kanë të bëjnë me angazhimin e:

- Asistentit arsimorë

Personat e papunësuar që shprehin interesim, Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, mund ti parashtrojnë në Agjencinë për punësime të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit, në periudhën nga 05.08.2019 deri më 16.08.2019, nga ora 08:00 deri në ora 14:00 .

Kushtet më konkrete, të drejtat dhe obligimet do të rregullohen me lidhjen e Kontratës në mes Qytetit të Shkupit dhe kandidatët e përzgjedhur.

Informacione më të detajuara në lidhje me Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, mund të fitohen në Sektorin për arsim pranë Qytetit të Shkupit, te personi Sulltana Çuleva, Koordinator komunal për Programin “Angazhime në punët e dobishme komunale”, Agjencia për punësime e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Qendra për punësime e qytetit të Shkupit, te personi Ivona Zhivkoviç, Qendra mes komunale për punë sociale - Shkup, te personi Bojana Stoilkovski.